

Fjalë përshëndetëse e Prof. Dr. Naim Berishës, Drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës

E nderuara profesoreshë Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

E nderuara profesoreshë Teuta Shala, Drejtoreshë e Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë,

I nderuar ambasador i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia Juaj, z. Skënder Durmishi,

Të nderuar kolegë nga institucionet bashkorganizuese,

Të nderuar të pranishëm,

Kam kënaqësinë t’ju përshëndes dhe t’ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë shkencore, e cila trajton një prej çështjeve më të ndjeshme dhe më komplekse të historisë shqiptare të shekullit XX, kalimin e kufirit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, atëbotë pjesë e Jugosllavisë, gjatë viteve 1944–1991.

Vetë tema e konferencës na fton ta shohim kufirin jo vetëm si një vijë gjeografike dhe politike që ndante dy hapësira shqiptare, por edhe si një realitet që preku drejtpërdrejt jetën e individëve, familjeve dhe komuniteteve. Kufiri ishte njëkohësisht hapësirë kontrolli, përndjekjeje dhe ndarjeje, por edhe një pikë ku u përplasën politika, ideologjia, kujtesa dhe përvoja njerëzore.

Në këtë kuptim, programi i konferencës së sotme është konceptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke e trajtuar këtë problematikë nga këndvështrime të ndryshme: marrëdhëniet politike, shoqërore dhe kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës; dokumentet dhe burimet arkivore; historiografinë dhe kujtesën historike; si dhe çështjet e kufirit, përndjekjes, emigrimit politik dhe përvojës së individit.

Një vlerë të veçantë ka qasja që i bashkon këto dimensione dhe që e vendos dokumentin historik në raport të drejtpërdrejtë me përvojën njerëzore. Pas çdo dokumenti, dosjeje apo raporti administrativ qëndron një histori konkrete, një individ, një familje dhe një përvojë që meriton të hulumtohet e të dokumentohet. Prandaj, studimi i kësaj periudhe kërkon jo vetëm analizën e politikave dhe mekanizmave institucionalë, por edhe rikthimin e dimensionit njerëzor të historisë.

Për Institutin Albanologjik të Prishtinës, kjo konferencë është një dëshmi e rëndësishme e vlerës që ka bashkëpunimi ndërinstitutional në kërkimin shkencor. Bashkëpunimi me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe me Institutin e Historisë “Ali Hadri” krijon mundësi për shkëmbimin e burimeve, përvojave dhe rezultateve kërkimore, mbi të gjitha, për zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

Në këtë kuadër, Marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar ndërmjet Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe AIDSSH-së më 12 shtator 2025 është një bazë e rëndësishme për ta thelluar këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen, përmes hulumtimeve të përbashkëta, punës me dokumentet arkivore, botimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera kërkimore. Prandaj, kjo konferencë nuk duhet parë vetëm si një veprimtari e rëndësishme shkencore e ditës së sotme, por edhe si një pikënisje për bashkëpunime të reja dhe për studime të mëtejme me mbi këtë periudhë. Historia e kufirit Shqipëri–Kosovë dhe përvojat që lidhen me të kanë ende shumë aspekte që kërkojnë të hulumtohen, të dokumentohen dhe të interpretohen në mënyrë shkencore.

Në këtë frymë, dëshiroj t'i falënderoj kolegët dhe institucionet bashkorganizuese për bashkëpunimin dhe kontributin në realizimin e kësaj veprimtarie, duke shprehur bindjen se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në projekte të tjera të përbashkëta.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju uroj punë të mbarë e diskutime të frytshme gjatë konferencës.

Ju faleminderit!